



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština -Municipality of Prishtina

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

**të mbledhjes së dhjetë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, mbajtur më 27.12.2019, e cila
filloi në orën 10:00.**

Në mbledhje morën pjesë: Agim Kuleta, kryesues i Kuvendit, këshilltarët e Kuvendit: Vala Peshku, shefe e GP-së (PSD), Nol Nushi (PSD), Drilon Pireva (PSD), Bashkim Beha (PSD), Genc Sherifi (PSD), Mimoza Sylejmani (PSD), Visare Gashi (PSD), Qëndrim Sahiti (PSD), Adrian Berisha (PSD), Valbona Petrovci, e pavarur, Leonora Shabani - Bajraktari, shefe e GP-së (LVV), Vjosa Hamiti - Krasniqi (LVV), Eman Rrahmani (LVV), Egzon Azemi (LVV), Besnik Mujeci (LVV), Halim Halimi, shef i GP-së (LDK), Sami Salihu (LDK), Milazim Vitija (LDK), Shefqet Osmani (LDK), Agim Gashi (LDK), Shefki Gashi (LDK), Haki Dragusha (LDK), Vlora Dumoshi (LDK), Elmire Nikçi - Rexha (LDK), Mustafë Krasniqi (LDK), Jeta Rafuna - Hasani (LDK), Kushtrim Sopa (LDK), Naime Osmani (LDK), Hafiz Krasniqi (LDK), Blerand Stavileci, shef i GP-së (PDK), Kumrije Shabani - Ramadani (PDK), Leutrim Retkoceri (PDK), Florida Canolli (PDK), Suzan Kika, (PDK), Yll Bogaj (AAK), Fadil Gashi, shef i GP-së (AAK), Valbona Ajeti (AAK), Bukurie Canolli (AAK), Fikneta Bejta (AAK), Sami Boroci, (AKR), Arbenita Murseli (AKR), Adelina Fazliji (AKR), Rifat Deri, i pavarur, Sokol Berisha, i pavarur dhe Baton Dushi (Nisma).

Munguan: Arbër Vokrri (LVV), Mirsad Vitia (LVV), Vesel Makolli, shef i GP-së (AKR) dhe Migjen Shala (PDK).

Të pranishëm ishin edhe: Shpend Ahmeti, kryetar i Komunës, Gëzim Mehmeti, drejtor i Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, Ardian Olluri, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, Blerta Basholli, drejtoreshë e Drejtorisë së Kulturës, Valbona Makolli, drejtoreshë e Drejtorisë së Financave, Shpresa Shala, drejtoreshë e Drejtorisë së Arsimit, Genc Bashota, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, Fatime Hajdari, drejtoreshë e Drejtorisë së Parqeve, Dren Kukaj, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Bujar Gashi, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë, Valbona Osmani, drejtoreshë e Drejtorisë së Kadastrit, Ardit Byci - Jakupi, mësimdhënëse pranë UP-së, njëra nga hartueset e Planit rregullues të hollësishëm lidhur me kampusin teknik, Osman Bllaca, përfaqësues i ekzekutivit, përfaqësues të Ministrisë së

Administrimit të Pushtetit Lokal, përfaqësues të OJQ-ve, përfaqësues të OSBE-së dhe përfaqësues të medjeve të shkruara dhe elektronike.

Para se të fillonin me diskutimin për rendin e ditës, kryetari, Shpend Ahmeti, kërtoi nga t pranishmit që të bëhet një minutë heshtje në shenjë nderimi për punëtorin e Komunës, Nazm Rrustemi, i cili humbi jetën tragjikisht.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Agim Kuleta, kryesues i Kuvendit, dhe konstatoi se me 32 vot për, u miratua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i ekstrakteve të procesverbaleve të mbledhjes së nëntë dhe mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës së Prishtinës;
2. Informatë mbi menaxhimin e emergjencave në Komunën e Prishtinës;
3. Propozimvendimi për tatim në pronën e paluajtshme;
4. Propozimrregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale, 01. nr. 110-2782, dt. 02.12.2011;
5. Propozimvendimi për lënie në shqyrtim publik të projektdokumentit të Planit rregullues të hollësishëm për zonën te Fakulteti Teknik, në lagjen "Bregu i Diellit";
6. Propozimvendimi për formimin e grupit punues për hartimin e planit vjetor të punës së Kuvendit për vitin 2020;
7. Propozimvendimi për lirimin nga taksa për legalizimin e ndërtimeve pa leje, si dhe mënyra e caktimit të kësteve;
8. Propozimvendimi për miratimin e çmimores për parkingjet publike të Komunës së Prishtinës;
9. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Asllan (Osman) Ahmetit;
10. Propozimvendimi për ndarjen e mjeteve ndërmarrjes publike lokale "Sport Marketing", SHA, në Prishtinë;
11. Pyetje dhe përgjigje;
12. Të ndryshme.

Pika e parë

Miratimi i ekstrakteve të procesverbaleve të mbledhjes së nëntë dhe mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës së Prishtinës.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri, më 34 vota për, u miratuan ekstraktet e procesverbaleve të mbledhjes së nëntë dhe mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës së Prishtinës.

Pika e dytë

Informatë mbi menaxhimin e emergjencave në Komunën e Prishtinës.

Lidhur me Informatën për menaxhimin e emergjencave në Komunën e Prishtinës, të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Medina Braha, drejtoreshë e Drejtorisë së Shërbimeve Publike.

Agim Gashi theksoi se Komuna e Prishtinës ka hartuar dy planet obliguese, por mendoj që ato kapacitete që i kemi, duke përfshirë njësitë e zjarrfikësve, disa shoqata të alpinistëve, disa shoqata të ndryshme profesionale, grupet tjera të interesit, institucionet edukativo arsimore institucionale të kulturës dhe institucionale të tjera publike që veprojnë në kryeqytet dhe në komunën tonë, të angazhohen dhe të kryejnë obligimet ligjore karshi zhvillimit të preventivës në fushën e emergjencave.

Me emergjenca nuk nënkuftojmë vetëm sistemin e alarmimit, posedimin e disa strehimoreve, njësinë e zjarrfikësve, por nënkuftojmë edhe të tjerat, edhe bashkëpunimin ndërinstitucional të policisë, zjarrfikësve, instrumenteve tjera qeverisëse brenda Komunës, të gjitha institucionet private dhe publike, edukativo-arsimore, shoqatat profesionale etj. Ato kapacitete që i kemi dhe ato që ndoshta mund t'i krijojmë, por nuk i kemi, siç janë: njësia vullnetare e zjarrfikësve, pastaj edhe të tjerat që sipas nevojës mund të ndërtohen.

Këto janë disa nga elementet të cilat ne duhet t'i trajtojmë, por së pari duhet pas njerëz profesionistë që i përcjellin këto fusha dhe i nxisin edhe debatet, paraqesin projekte të ndryshme, na nxisin që edhe ne të merremi, të ndihmojmë në zhvillimin e kësaj fushe.

Suzan Kika tha se në bazë të materialit që e kemi përpara, më shumë e shoh një rrugë procedurale të veprimit, sesa diçka reale për veprim. Struktura e veprimit, së pari, nuk është mirë e detajuar dhe nuk e ka mbështetjen bazë për veprim, me ç'rast në një situate emergjente, apo në një fatkeqësi natyrore, do të jenë të paanashkaluar, e që janë këshillat apo bashkësítë lokale.

Rasti i Shqipërisë, duhet të na vetëdijesojë dhe të na ndërgjegjësojë, për të qenë të gatshëm për veprim dhe të koordinuar. Trajnimet për këtë fushë duhet të janë gjithandej territorit të kryeqytetit, që secili institucion publik duhet ta ketë këtë trajnim bazë.

Shefki Gashi shprehu mendimin se, për fat të keq, fatkeqësitet natyrore, si p.sh. rasti i tërmetit në Shqipëri, mund të na ndodhin çdoherë, kur dihet se te ne ka objekte të ndërtuara në periudha të ndryshme, me materiale e ndërtimë të lloj-llojlojshme e që ato ndërtimë paraqesin një rrezik të madh në rast të tërmetit. Do të ishte mirë që ato objekte të identifikohen, të cilat në raste të caktuara nuk e kanë forcën sizmike diku në 7-8 shkallë të Rihterit.

Sa i përket ndarjes së mjeteve për emergjenca, mendoj se janë shumë pak. Mendoj që edhe ndërmarrjet tjera private që kanë mjete të ndryshme, qoftë të ekskavatorëve, kamionëve, cisternave e llojeve tjera, edhe ato shteti mund t'i fus në evidencën e vetë, që në rast nevoje me pasur kontakte me to.

Eman Rrahmani kërkoi të dijë se pse nuk është aktivizuar alarmi lidhur me tërmetin e fundit që ndodhi edhe në Kosovë.

Shpend Ahmeti, Kryetar, tha se për tu aktivizuar alarmi, duhet ta mbërrijmë një shkallë të caktuar të emergjencës, në mënyrë që mos të shkaktohet panik te popullata, dhe ajo shkallë

nuk është arritur, prandaj janë të përcaktuara nivelet prej Agjencisë së Menaxhimit të Emergjencave, që do të duhet të na tregonin se kur duhet të lëshohet alarmi.

U konstatua se u përkrah Informata mbi menaxhimin e emergjencave në Komunën e Prishtinës.

Pika e tretë

Propozimvendimi për tatim në pronën e paluajtshme.

Kryesuesi konstatoi se më 34 vota për dhe 6 abstenime, u miratua Vendimi për tatim në pronën e paluajtshme.

Pika e katërt

Propozimrregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale, 01. nr. 110-2782, dt. 02.12.2011.

Kryesuesi konstatoi se më 36 vota për dhe 3 abstenime, u miratua Rregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale, 01. nr. 110-2782, dt. 02.12.2011.

Pika e pestë

Propozimvendimi për lënie në shqyrtim publik të projektdokumentit të Planit rregullues të hollësishëm për zonën te Fakulteti Teknik, në lagjen "Bregu i Diellit".

Lidhur me Propozimvendimin për lënie në shqyrtim publik të projektdokumentit të Planit rregullues të hollësishëm për zonën te Fakulteti Teknik, në lagjen "Bregu i Diellit", Ardit Byci - Jakupi, bëri prezantimin e këtij plani rregullues në mënyrë elektronike.

Vala Peshku shtroi pyetje se cila është arsyja që në këtë zonë duhet pas parkingje edhe jashtë kompleksit. Po ashtu, kërkoi të dijë se në bazë të cilit kriter janë përcaktuara lartësitë e objekteve të këtij kompleksi.

Eman Rrahmani shprehu mendimin se këto plane po e bllokojnë hartimin zonal dhe planin zhvillimor, gjë të cilën ne e kemi paralajmëruar qysh nga fillimi i vitit 2019, e që na është premtuar që në shtator të vitit 2019, do të jetë e përfunduar Harta zonale dhe Plani zhvillimor. Neve këtu na vijnë plane të hollësishme për Prishtinën e Re, mirëpo nuk vijnë planet e hollësishëm për lagjet "Kolovica", "Kodra e Trimave", "Tophanen", për shumicën e vendeve të cilat vuajnë për një plan të hollësishëm, ku edhe kishin filluar me u ringjallur ato pjesë.

Sa i përket këtij projekti, arsyja që ne do të abstenojmë është për shkak të mos realizimit të Hartës zonale dhe Planit zhvillimor. Këtë e kemi bërë të ditur çdo herë se nuk do të votojmë asnjë plan të hollësishëm pa përfunduar Harta zonale dhe Plani zhvillimor.

Halim Halimi tha se në bazë të Ligjit për planifikim hapësinor, kur kemi të bëjmë me plane të hollësishme rregulluese, duhet të jenë në harmoni me Ligjin e planifikimit hapësinorë dhe në mbështetje me Hartën zonale.

Me që Harta zonale nuk është bërë, tash po kërkojmë plane rregulluese të hollësishme. Nuk besoj që kjo është në disharmoni me dispozitat ligjore, mirëpo duke e ditur që Fakulteti i Shkencave Matematike Natyrore punon në kushte jashtëzakonisht të vështira, me qenë se

është fakultet, unë mendoj që grupi ynë këtë plan rregullues do ta votojë për miratim, përndryshe, po të ishte ndonjë objekt tjetër, ne sigurisht se do të votonim kundër.

Vlora Dumoshi tha se qytetit të Prishtinës, si një metropol, i mungon një sallë e koncerteve të operës dhe baletit, jo me përmasa siç është paraparë ajo para sa vitesh, por një sallë e cila i përbush kriteret dhe kërkesat e jetës kulturore të kryeqytetit. Sa i përket këtij plani, e përkrah miratimin e tij për ndërtimin e kësaj pjese të fakulteteve që janë në një gjendje shumë të rëndë. **Visare Gorani - Gashi** e falënderoi prezantuesen për prezantimin e këtij plani rregullues, por lidhur me këtë plan shprehu dilemë në objektet e ndërtimit, kryesisht rrëth pjesës T 6, duke thënë se ajo pavarësisht që e krijon atë tunelin që do të jetë aty, mendoj se do ta humbte atë identitetin e jetës komunitare. Me atë pjesë të qytetit do të jetë shumë vështirë korpusi i qytetarëve që do të jenë edhe aktivë edhe do te krijojnë lidhje të ndryshme, të cilat quhen si rrjeti mbrojtës i qytetarëve. Andaj, për atë pjesë kisha me qenë shumë e rezervuar.

Egzon Azemi pyeti se kur parashihet fillimi i punimeve të këtij projekti, nëse ka eventualisht ndonjë datë, dhe kur paramendohet afërsisht me përfunduar Harta zonale.

Sami Salihu u shpreh se e kuptoj nevojën urgjente të fakulteteve për krijimin e hapësirave të reja dhe e ndaj të njëtin mendim me parafolësit, sepse edhe unë aty isha student dhe e kam parë në çfarë gjendjen ndodhet ai fakultet. Por, një brengë që unë e kam është se lokacioni nuk është vend i duhur, andaj pse të mos e bëjmë një destinim tjetër të kampusit, diku në periferi të Prishtinës.

Mustafë Krasniqi theksoi se gjatë prezantimit të këtij plani rregullues, nga qytetarët janë dhënë shumë vërejtje, por ka pasur edhe kërkesa të tilla, që ky projekt të dislokohet jashtë qytetit të Prishtinës, ku dhe janë bërë vërejtjet kryesore prej banorëve të asaj lagjeje. Ata ishin me kërkesë këmbëngulëse që kompleksi T6, ajo pjesa ku është Fakulteti i Inxhinierisë dhe Makinerisë, ose të dislokohet në një afërsi me Fakultetin e vjetër Teknik, ose diku tjetër. Mendoj që është një projekt mjaft mirë i punuar, andaj ne duhet t'i japim pëlqimin dhe ta përkrahim që të shkojë në diskutim publik.

Lidhur me sugjerimet dhe vërejtjet e ngritura nga parafolësit, sqarime shtesë dhanë kryetari, Shpend Ahmeti, dhe Arditë Bici- Jakupi, hartuese e këtij plani rregullues.

Kryesuesi konstatoi se më 26 vota për dhe me 6 abstenime, u miratua Vendimi për lënien në shqyrtim publik të projektdokumentit të Planit rregullues të hollësishëm për zonën te Fakulteti Teknik, në lagjen "Bregu i Diellit".

Pika e gjashtë

Propozimvendimi për formimin e grupit punues për hartimin e planit vjetor të punës së Kuvendit për vitin 2020.

Halim Halimi: Për anëtar të grupit punues propozoj Sami Salihun (LDK);

Eman Rahmani: Për anëtar të grupit punues propozoj Mirsad Vitinë (LVV);

Vala Peshku: Për anëtar të grupit punues propozoj Baton Dushin (PSD);

Blerand Stavileci: Për anëtar të grupit punues propozoj Leutrim Retkocerin (PDK);

Fadil Gashi: Për anëtar të grupit punues propozoi Bukuriye Canollin (AAK);

Sami Boroci: Për anëtar të grupit punues propozoj Adelina Fazliu (AKR);

Kryetari, Shpend Ahmeti për anëtar të grupit punues propozoi Osman Bllacën, përfaqësues i ekzekutivit.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri, më 35 vota për, u miratua Vendimi për formimin e grupit punues për hartimin e planit vjetor të punës së Kuvendit për vitin 2020.

Pika e shtatë

Propozimvendimi për lirimin nga taksa për legalizimin e ndërtimeve pa leje, si dhe mënyra e caktimit të kësteve.

Eman Rrahmani shprehu mendimin se kishte qenë mirë me u formuar një komision ose prej Kuvendit, ose prej Drejtorisë së Mirëqenies Sociale, për t'i verifikuar personat, ose këto kategori të cilat janë të propozuara për lirim nga taksa. Nuk është në rregull që në këtë mënyrë të lirohen të gjithë këta persona, për shkak se është numër shumë i madh dhe ka një kosto shumë të lartë për Komunën.

Kryesuesi konstatoi se më 31 vota për dhe 4 abstenime, u miratua Vendimi për lirimin nga taksa për legalizimin e ndërtimeve pa leje, si dhe mënyra e caktimit të kësteve.

Pika e tetë

Propozimvendimi për miratimin e çmimores për parkingjet publike të Komunës së Prishtinës.

Eman Rrahmani theksoi se ne, si Grup parlamentar, për këtë çmimore të parkingjeve kemi disa propozime dhe kërkojmë që këto të hedhen në votim:

- Propozoj që rruga "B" të përfshihet në zonën e parë, sa i përket parkingjeve, për shkak të ngarkesës së madhe që ka. Mendoj që është njëfarë lloj standardi i njëjtë me zonën e parë;
- Propozoj që ditëve të premte dhe të shtuna orari i arkëtit të zgjatet deri në orën 24:00, kurse te biletat e parkimit të privilegjuar, kërkojmë që në pikën 2, nënpika "c" të largohet, arsyja është që krijon një pamundësi të parkingu të banoreve në këtë zonë, për shkak të numrit të madh të punëtorëve, sidomos në zonën e parë;
- Te tarifat me parkingjet e privilegjuara duhet të ketë disa ndryshime, sidomos te biletat mujore të personave juridikë, mendoj se duhet të bëhen nga 45 euro në 60 euro;
- Biletat vjetore për persona juridikë, zona e parë, nga 400 euro në 600 euro;
- Te zona e dytë, bleta mujore për personat juridikë, nga 30 euro të bëhet 45 euro;
- Bleta vjetore nga 300 euro të bëhet 450 euro;
- Në zonën e tretë, për persona juridikë, nga 15 euro të bëhet 30 euro, dhe nga 150 euro të bëhet 300 euro.

Agim Gashi tha se ne lidhur me këtë propozim shohim problemin kryesor te banorët rezidentë. Duke marrë parasysh mungesën e parkingjeve dhe presionin që bëhet në ato zona nga të gjithë nevojtaret, qoftë ata që vijnë nga jashtë, qoftë ata që bëjnë biznes, qoftë të tjerët, në kushte normale ky çmim nuk është i lartë sipas zonave. Por në kushte të cilët ne do të fillojmë me aplikuar këtë, mendoj që po e ngarkojmë dhe nuk po e zgjidhim problemin, prandaj propozimi im është sipas zonave për banorët rezidentë të lirohet 20%.

Tash problemi është se si të pengohen ato vutura që vijnë prej komunave të tjera, pra si me gjetur një mënyrë, me pasur përparësi në autoparkingje ata që janë banorë rezidentë të komunës së Prishtinës.

Sami Salihu shprehu mendimit se çmimet e parkingjeve për banorët e zonës 1 dhe 2, janë të larta dhe duhet bërë një ndryshim. Ai kërkoi të dijë se kur do të fillojë realizimi i këtij projekti dhe a do të ketë favore për një familje e cila posedon më shumë se një veturë, për banorët rezidentë. Gjatë realizimit të parkingjeve do të duhej të parashihej në projekt edhe vendosja e kamerave në të gjitha vendparkingjet.

Adrian Berisha tha se duke pasur parasysh që Prishtina është e mbingarkuar me automjete të ndryshme, propozoj që të bëhet kohëzgjatja e orarit për parkingje.

Fadil Gashi pyeti se si munden qytetarët, si p.sh. ata të lagjes "Kodra e Diellit" me pasur qasje te pagesa, a është bërë ndonjë planifikim se sa banorë janë në atë lagje, dhe se ai parking a i furnizon të gjithë, a ka kushte të mjaftueshme, a ka siguri etj. Pra çështja është se si mund ta bëjmë një planifikim që njerëzit të mos krijojnë konflikt ndërmjet veti.

Hafiz Krasniqi theksoi se nga parafolësit u dhanë edhe propozime të ndryshme për ndryshimin e çmimores, por mendoj se për këto propozime është shumë vonë të marrim një qëndrim, andaj duhet të përkrahet propozimi i cili u dha në KPF-së, sepse aty jemi të përfaqësuar nga të gjitha grupet parlamentare këtu në Kuvend.

Nol Nushi, lidhur me zonat që dallojnë me çmime, tha se ato mund të duket që në zonën e parë banorët kanë me pagur më shtrenjtë, por kjo është e njëjtë sikurse e tatimit në pronë. Zona "Qendër" pothuajse nuk është më zonë banimi, por është zona thuajse afariste dhe mendoj se çmimi për parking duhet të jetë më i lart sesa te zonat tjera.

Rregulloret e tillë nuk behën për t'i zgjidhur problemet e parkingut në pjesët e rrethinave të qytetit, por pikërisht duke shkuar prej qendrës e me rrathë koncentrik, sepse probleme për parking ka kryesisht në zonën 1 dhe 2, zona 3 fillon duke u lehtesuar.

Edhe unë e mbështesë ndryshimin që kohëzgjatja për parkingje të jetë deri në ora 24:00.

Leutrim Retkoceri tha se në mungesë të hapësirave, do të jetë problem i madh çështja e autoparkingjeve. Më parë u cek nga kryetari se fillimi do të startohet me 200 vendparkingje, mendoj se është numër shumë i vogël.

Ai kërkoi nga kryetari të dijë se si do të sigurohen hapësirat e nevojshme për parkingje në këto rrugë, në këto kushte, dhe sa vendparkingje kanë me u siguruar në komunën e Prishtinës.

Jeta Rafuna - Hasani u shpreh e pajtimit me dy parafolësit, të cilët propozuan uljen e çmimit për banorët rezidentë. Propozoj që bleta mujore për banoret e tri zonave të lirohen për 20%, duke e pasur parasysh se pagesa nuk ua garanton vandin e rezervuar të veturave. Gjithashtu te pika 2, nënpika (c), kisha propozuar që të punësuarit të cilët punojnë në zonat ku parkingu paguhet, të hiqet nga ky vendim, sepse dihet, sidomos në zonën e qendrës, më shumë janë bërë biznese sesa banorë dhe kjo ua pamundëson banorëve qasjen e parkingut afër banesave të tyre.

Mimoza Sylejmani propozoi që pjesa te Santea, në lagjen "Dardania", të përfshihet në zonën I, që pagesa të jetë më shumë se 0.50 centë, me arsyetimin se aty afër është KEDS-i, ka shumë automjete dhe rrinë pothuajse të parkuara tërë ditën.

Vlora Dumoshi u shpreh e kënaqur që po diskutohet një pikë, e cila e ka një rëndësi shumë të madhe për qytetin e Prishtinës, e cila është në interes të të gjithë qytetarëve të Prishtinës, sepse Prishtina vërtetë është kryeqytet, ku krijohet tollovi e madhe e makinave, e shpesh edhe kaos, sidomos për parkingjet. Nuk pajohem me propozimin që te pjesa e Santesë të rritet çmimi i parkingut. Si qytetare që banojmë në atë pjesë, nuk kemi se ku t'i parkojmë veturat, pasi që ai parking shfrytëzohet prej të gjithë qytetarëve dhe bizneseve të ndryshme. Kërkoj të dijë nga kryetari, se a është menduar ndonjë herë që në periferi të qytetit të ndërtohet ndonjë autoparking i madh, që veturat të mos hyjnë në qytet.

Lidhur me vërejtje dhe shqetësimet e ngritura nga parafolësit, sqarime shtesë dhanë Shpend Ahmeti, kryetar, dhe Medina Braha, drejtoreshë e drejtorisë së Shërbimeve Publike.

Me propozimin që të bëhet kohëzgjatja e orarit për venparkingje deri në ora 24:00, dhe propozimi që në pikën 2 (biletat mujore dhe vjetore të parkingut) të hiqet nënpika (c), kryesuesi konstatoi se më 36 vota për dhe 1 abstenim, u miratuan këto dy propozime.

Kryesuesi konstatoi se më 36 vota për dhe 3 abstenime, u miratua Vendimi për miratimin e çmimores për parkingjet publike të Komunës së Prishtinës.

Pika e nëntë

Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Asllan (Osman) Ahmetit.

Lidhur me Propozimvendimin për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, me pronën e paluajtshme në pronësi të Asllan (Osman) Ahmetit, në pika të shkurtra të pranishmit i informoi Shpend Ahmeti, kryetar.

Agim Gashi tha se në materialin e prezantuar vërehet se mungojnë disa të dhëna, që kanë të bëjnë me sipërfaqen e propozuar, kështu që është dashtë të precizohet se sa sipërfaqe jepet dhe sa i merret, sepse është rregull. Mendoj që nuk duhet të kontestohet çështja e marrjes së këtij vendimi, por dokumenti duhet të kompletohet.

Eman Rahmani theksoi se sa i përket shkëmbimit të pronave, kamë kërkuar disa herë që të na sillet vlerësimi i këtyre pronave që bëhet prej Ministrisë së Financave, por kjo nuk është duke ndodh asnjëherë, pra duhet të shihet një krahasim se çfarë vlere po japim dhe çka po shkëmbejmë.

Leutrim Retkoceri ngriti shqetësimin rrëth dhënies së lejes për ndërtimin e atyre objekteve në atë parcelë. Si është e mundur që të lëshohen lejet për ndërtim të objekteve, pa pasur qasje në at pronë?!

Shefki Gashi kërkoi që atyre qytetarëve t'u bëhet një zgjidhje, në mënyrë që ata të kenë qasje në objektet e tyre, dhe kërkoi që ky këmbim të votohet.

Lidhur me sugjerimet dhe vërejtjet e ngritura nga parafolësit, sqarime shtesë dha Shpend Ahmeti, kryetar.

Kryesuesi konstatoi se më 31 vota për, 1 kundër, u miratua Vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, me pronën e paluajtshme në pronësi të Asllan (Osman) Ahmetit.

Pika e dhjetë

Propozimvendimi për ndarjen e mjeteve ndërmarrjes publike lokale "Sport Marketing", SHA, në Prishtinë.

Egzon Azemi kërkoi nga kryetari i Komunës që të zotohet publikisht, që aksionarëve të kësaj ndërmarrjeje t'iu japë mandat, që këta aksionarë të kërkojnë nga Bordi dhe ta bëjnë ndryshimin e statusit të kësaj ndërmarrje publike. Nuk ka asnjë kuptim që kjo gjendje me vazhduar e tillë kështu. E vëmja zgjidhje është që edhe për këtë vit po i ndajmë një pjesë të mjeteve financiare, dhe si lëvizje do ta votojmë nëse do të merret parasysh propozimi i ynë. Po ashtu, do të ishte mirë që të formohet mbështetje edhe një grup punues, i cili hulumton se cilat kompetenca mund t'i shtohen kësaj ndërmarrjeje.

Sami Boroci tha se më herët kam propozuar që kësaj ndërmarrjeje me iu zgjeruar operatorët ekonomikë dhe jo vetëm me Pishinën e Gërmisë. Do të ishte mirë t'i jepen në menaxhim edhe terrenet sportive, si salla "1 Tetori" dhe hapësirat reklamuese në Prishtinë. Për këto propozime kam kërkuar nga ekzekutivi i Komunës që të merren hapa konkret për të lëvizur në këtë drejtim.

Agim Gashi theksoi se është më se e nevojshme që kjo ndërmarrje ta zgjerojë veprimtarinë e saj, në qoftë se ka fushë ku ajo mund të mbulojë, është mirë me bërë një gjë të tillë, dhe është mirë me arritur që me ndërtuar kapacitete që ajo të pavarësoset financiarisht.

Por nuk është kurfarë dëmi në qoftë se ne e subvencionojmë një ndërmarrje, e cila prodhon efekte pozitive zhvillimore, me qenë se roli i saj ka të bëjë më shumë me institucionet edukativo arsimore, prandaj ne jemi për me e subvencionuar. Shqetësuese është Shtëpia e Gurit, e cila është shfrytëzua për më shumë se 10 vjet, dhe tanë pronësia e saj është e kontestuar. Ne duhet ta angazhojmë Zyrën ligjore, si dhe rrugët tjera, për ta mbrojtur atë objekt, sepse është objekt me interes.

Kushtrim Sopa u shpreh në mbështetje të këtij subvencionim, mirëpo herën e kaluar kemi ndarë mjete për të shpenzuar sipas destinacionit për shlyerje të borxheve. Ne gjatë viti kemi pasur disa raste ku janë ankuar punëtorët, ish anëtarë të bordit, që nuk janë shlyer të gjitha borxhet, por le të jetë i garantuar destinimi i këtyre mjeteve që ne po i ndajmë.

Lidhur me vërejtjet dhe shqetësimet e ngritura nga parafolësit, sqarime shtesë dha Shpend Ahmeti, kryetar.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri, më 37 vota për, u miratua Vendimi për ndarjen e mjeteve ndërmarrjes publike lokale "Sport Marketing", SHA, në Prishtinë.

Pika e njëmbëdhjetë Pyetje dhe përgjigje

Naime Osmani, për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave dhe për drejtorin e Drejtorisë së Shëndetësisë:

Qytetarët e lagjes “Kodrës së Trimave” shtrojnë pyetjen:

- Pse janë ndërprerë punimet në rrugën “Arif Shala”, vetëm për 100m ka mbetur pa u shtruar ajo rrugë? Kjo është pronë publike dhe i kanë shtyrë me u tërheqë makineritë e kompanisë, me arsyetimin se dikur në pranverë do të asfaltohet.
- Një qytetarë kërkon të dijë arsyen se përse nuk iu ka ndarë ndihma nga Drejtoria e Shëndetësisë, i cili ka aplikur më 8.4.2019, ndihma këto të cilat Komuna i ndanë për rastet e veçanta sociale.

Bujar Gashi, drejtor, tha se kryesisht në këtë vit janë ndihmuar personat me sëmundje malinje, kanceroze. Me buxhetin që kemi pasur janë ndihmuar edhe një pjesë e pacientëve që janë në dializë, pra janë shpenzuar vetëm për këto kategoritë më të rënda shëndetësore.

Leonora Shabani - Bajraktari, për drejtoreshën e Drejtorisë së Arsimit:

Në muajin e fundit kanë ndodhur disa skandale në shkollat e Prishtinës.

- Çfarë vendimi është marrë për arsimtaren e Historisë në shkollën “Emin Duraku”?
- Çfarë vendimi është marrë për arsimtarin që ka bërë ngacmimë seksuale në shkollën “Nazim Gafurri”?

Shpresa Shala, drejtoreshë, tha se lidhur me mësimdhënësen në shkollën “Emin Duraku”, me vendim të komisionit disiplinor, ajo është suspenduar.

Për rastin në shkollën “Nazim Gafurri”, në mungesë të provave, komisioni disiplinor nuk ka pas çka me vendosur tjetër, vetëm me lënë në punë.

Egzon Azemi, për drejtoreshën e Drejtorisë së Shërbimeve Publike:

Shtyllat e ndriçimit që kanë qenë të vjetra, janë prerë një gjysmë metër dhe shtyllat e reja janë vendosur po në atë vrimë, por nuk e di sa janë të sigurta ato.

- Si është paraparë tenderi, a është paraparë me u rivendosur krejtësisht, apo është përmendur edhe aty që mundet me u shfrytëzuar infrastruktura e mëhershme?

Lidhur me pyetjen e parashtruar, Shpend Ahmeti, kryetar, tha se çdo tenderë që është i paraparë për ndriçim, është i publikuar në Open Contrat Softwer”, pra si tender është i specifikuar çdo fazë e tij, prej kur është hapur deri te kontrata.

Sami Boroci, për drejtoreshën e Drejtorisë së Shërbimeve Publike:

Një numër i konsideruar i banorëve të lagjes “Kalabria”, kërkojnë që të bëhet ndriçimi pothuajse i të gjithave rrugëve të kësaj lagjeje.

Banorët e lagjes "Kalabria" kanë kërkuar që QMF-ja e kësaj lagjeje, ta zgjasë orarin dhe t'u ofrojë disa shërbime tjera, përvèç shërbimeve ekzistuese.

Medina Braha, drejtoreshë, tha se në rastet që po ndërhynë KEDS-i, që po e kalon rrjetin ajror në rrjet nëntokësor, po na e dëmton ndriçimi. Tani ne jemi duke e realizuar kontratën dhe do të përfshihet edhe ajo pjesë e lagjes.

Bujar Gashi, drejtor, tha se Qendra e Mjekësisë Familjare në lagjen "Kalabria", është si çdo qendër tjetër dhe punojnë në bazë të një udhëzimi administrativ, por zgjatje të orarit nuk mundet të ketë, e as kujdestari.

Eman Rahmani, për drejtorin e Drejtorisë së Pronës dhe për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave:

-Banorët e fshatit Prugovc kërkojnë që t'i ndahet një parcelë për ndërtimin e një shtëpie të përbashkët, e cila do të shërbente për nevojat e banorëve për rastet e veçanta, si për të pame dhe për nevoja të tjera të qytetarëve.

-Banorët e fshatit Bardhosh kërkojnë që të ndërtohet rrjeti i kanalizimit, prej rrugës te "Albi" e deri te kisha, po ashtu edhe ndërtimin e rrugës e cila është jashtëzakonisht e dëmtuar.

- Banorët e lagjes "Kodra e Trimave" kërkojnë që një pjesë e rrugës e cila ka mbetur pa u rregulluar, që shpie te objekti i panaireve, është në gjendje shumë të keqe edhe po shfrytëzohet prej atyre që hedhin mbeturina inerte. Rregullimi i saj do ta evitonë edhe hedhjen e mbeturinave në atë pjesë.

Milazim Vitia, për drejtorin e Drejtorisë së Inspeksionit dhe për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave:

-Banorët e fshatit Hajvali kanë shprehur shqetësimet e tyre lidhur me dëmtimin e rrugëve nga kamionët, të cilët i kanë shkatërruar të gjitha rrugët që e lidhin Hajvalinë me Prishtinën.

-Po ashtu, këta banorë kërkojnë që rruga e cila kalon afér trafostacionit të rregullohet dhe autobusët të bëjnë lëvizjen më të lirë, e që do të ishte një qasje më e lehtë për në Prishtinë.

-Pse janë ndërprerë punimet për rregullimin e varrezave të dëshmorëve në Marec, kur e dimë se mjetet janë të alokuara për atë punë? Kishte me qenë mirë ose me ritenderim ose me një punë tjetër, që të përfundojë ajo punë, sepse shpejt vjen prilli dhe e kemi përvjetorin e dëshmorëve.

-Pse është ndërprerë asfaltimi i rrugës Qukë e Pajtimit - Vakovc?

Adelina Fazliji, për drejtoreshën e Drejtorisë së Shërbimeve Publike

- Qytetarët e Hajvalisë kërkojnë të dinë se a është paraparë me u vendosur stacione të autobusëve në rrugën "Dëshmorët e Gollakut" në Hajvali.

Medina Braha, drejtoreshë, tha se këtë kërkesë e kemi me prioritet, kemi filluar me kontratë, është nënshkruar, dhe jemi duke i indentifikuar të gjitha vend-ndaljet e autobusëve në këtë lokacion.

Kushtrim Sopa, për kryesuesin e Kuvendit, drejtoreshën e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për drejtorin e Drejtorisë së Urbanizmit dhe për drejtorin e Drejtorisë së Inspektionit:

1. A po zbatohen masat e marra nga Kuvendi komunal i Prishtinës për përmirësimin e cilësisë së ajrit në kryeqytet, apo kanë mbetur vetëm në letër?
2. Pse nuk po parandalohen furrat e bukës, të cilat procesin e pjekjes e bëjnë me naftë?
3. Pse po zvarritet procedura e dhënies së lejes për zgjerim të kapaciteteve prodhuese-punuese, të kompanisë "Euro-Fruti" në fshatin Mramor, komuna e Prishtinës, biznes ky i cili bënë kultivimin e mjedrave dhe frutave të malit? Ata sigurisht se po i respektojnë kriteret e ndërtimit, si dhe kriteret tjera për marrjen e lejes për zgjerim. Janë kompani serioze vendore, që gjenerojnë vende të punës dhe prodhim vendor, në shumë raste fitojnë edhe grante nga BE. Pra, ju lutem, ne si Komunë t'i ndihmojmë dhe stimulojmë bizneset tona me lehtësime dhe përshtajtje procedurale karshi rregullave dhe ligjeve tona.
4. Ne si Komunë dhe Kuvend komunal, a mund të ulemi dhe të krijojmë strategji për evitimin e kaosit ose minimalizimit të ngarkesës në trafik, përvèç mungesës së parkingjeve dhe mbingarkesës me vetura nga qytetet tjera? Mendoj që ka hapësirë për ndërmarrjen e disa masave, me theks të veçantë të evitohen vendkalimet e shumta të këmbësorëve në rrugët e Zonës 1, sidomos tek rrethrrotullimet dhe gjithandej në qytet, specifisht tek Rrethi i Flamurit dhe tek objekti i vjetër i vjetër.

Mbledhja përfundoi në orën 13:25.

**Procesmbajtësi
Zijadin Gashi**

**Kryesuesi i Kuvendit
Agim Kuleta**



Faqe 12 nga 12